

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4620, datë 14.10.2020

**PËR MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË KUNDËRVAJTJES ADMINISTRATIVE PËR
MOSPËRDORIMIN E BARRIERËS MBROJTËSE (MASKËS), NËPËRMJET
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
(OSHEE)**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 23, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Institucionet përgjegjëse për vendosjen e gjobës për mospërdorimin e barrierës mbrojtëse (maskës) janë Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, në përputhje me aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

2. Policia e Shtetit apo Policia Bashkiake dërgon brenda 14 ditëve procesverbalin e vendosjes së gjobës në Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) sh.a./ Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP (OSHEE) sh.a. Ky procesverbal, në çdo rast, duhet të përmbajë minimalisht informacionin në lidhje me emrin, mbiemrin, atësinë, numrin e kartës së identifikimit, si dhe adresën e banimit të individit.

3. FSHU-ja, për rastet kur individët kanë kontratë furnizimi energjie, do të regjistrojë gjobën në faturën e energjisë elektrike të muajit respektiv. Kur FSHU-ja konstaton se individit nuk ka kontratë furnizimi të energjisë elektrike ose të dhënat e pasqyruara në gjobë nuk janë të plota apo nuk korrespondojnë me të dhënat në sistemin e faturimit të FSHU/OSHEE, i kthen procesverbalin e gjobës, sipas rastit, Policisë së Shtetit ose Policisë Bashkiake.

4. Gjoba, e përfshirë në faturën e energjisë elektrike, do të jetë titull ekzekutiv dhe nuk do të mund të paguhet pjesërisht apo e shkëputur nga fatura e energjisë elektrike. Pagesa jashtë afateve do të shoqërohet me kamatëvonesat përkatëse në përputhje me kontratën e energjisë elektrike të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

5. Mospagesa e gjobës, si pjesë përbërëse e faturës, do ta klasifikojë individin si debitor ndaj FSHU-së dhe kontrata përkatëse e energjisë elektrike do të dërgohet për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga Enti Rregullator i Energjisë.

6. Pagesat mund të bëhen pranë të gjitha zyrave përkatëse të përcaktuara nga FSHU-ja, pranë Postës Shqiptare dhe pranë çdo institucioni financiar ku paguhet fatura e energjisë elektrike.

7. FSHU-ja derdh gjithë vlerën e gjobës në buxhetin e shtetit në llogarinë e thesarit, duke përjashtuar komisionet e shpenzimeve administrative në masën 2%. Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake rakordojnë me OSHEE-në arkëtimet periodike në llogarinë bankare në emër të OSHEE-së nga pagesat e faturave të energjisë elektrike për individët që kanë kontratë me OSHEE-në dhe i nënshkruajnë dokumentin “Faturë për arkëtim”, në të cilin është specifikuar si më poshtë:

- a) kodi i rrethit Tiranë 3535;
- b) kodi i institucionit për Policinë e Shtetit 1016079 në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) ose për Policinë Bashkiake me kod institucioni 2101001 në SIFQ;
- c) kodin e llogarisë ekonomike të arkëtimit 7115422 - “Gjoba për mospërdorimin e maskës nga COVID-19” në SIFQ.

8. OSHEE-ja, në bazë të rakordimit periodik paraqet në bankën përkatëse dokumentin “Faturë për arkëtim” për të kryer transferimin e shumave të vjela nga gjobat në llogarinë bankare të të ardhurave jotatimore në emër të degës së Thesarit Tiranë sipas listës bashkëlidhur të IBAN-eve.

9. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë dërgon postën ditore bankare dhe rakordon periodikisht arkëtimet nga gjobat me strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake.

Ky udhëzim hyn në fuqi me menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKS 1

NUMRAT E LLOGARIVE BANKARE TË TË ARDHURAVE JOTATIMORE DHE IBAN-et E DEGËS SË THESARIT TIRANË

Nr.	Emërtimi i bankës	Nr. i llogarisë bankare	IBAN
1	Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)	AAISALTR/1701007600000460	AL17 2031 0019 1701 0076 0000 0460
2	Banka Credins	CDISALTR/589007	AL32 2121 1016 0000 0000 0058 9007
3	Alfa Bank	CRBAALTR/902020125000045319	AL25 9021 1209 0201 2500 0045 3199
4	Banka Amerikane e Investimeve (ABI)	EMPOALTR/000035449	AL88 2101 1012 0000 0000 0003 5449
5	Pro Credit Bank	FEFAALTR/107701190001	AL73 2091 1108 0000 1077 0119 0001
6	Banka e Pare e Investimeve (FIB)	FINVALTR/43400020900256900	AL28 2151 1031 ALL5 3000 0025 6900
7	Banka Nderkombetare Tregtare (ICB)	ICOAALTR/000030300023900	AL44 2071 1032 0000 0303 0002 3900
8	Banka Kombetare Tregtare (BKT)	NCBAALTX/401279588OLTHES ALLAL	AL91 2051 1014 0127 9588 OLTHE SALLA
9	OTP Bank (B.POPULLORE)	PUPPALTR/00000211514	AL27 2131 1013 0000 0000 0021 1514
10	Raiffeisen Bank	SGSBALTX/0104030780	AL22 2021 1013 0000 0001 0403 0780
11	Tirana Bank	TIRBALTR/0100820000009	AL80 2061 1004 0000 1003 2000 0100
12	Union Bank	UNALALTR/111100925160118	AL61 2141 1209 0111 1009 2516 0118
13	Intesa Sanpaolo Bank (B. Amerikane)	USALALTR/2014730702	AL15 2081 1008 0000 0020 1473 0702